

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

Sot, me date 14.02.2025 (dymijë e njëzetepesë) në Tiranë u mbledhën ortakët e mëposhtëm dhe vendosën themelimin e shoqërisë Red Cat Studio sh.p.k sipas neneve të parashikuara në këtë statut.

Z.Renis Hyka, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 11.09.1991, me pasaportë shqiptare, identifikuar me Numer Personal J10911053N, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Z.

Prifti, shtetas shqiptar, lindur në Fier më 06.02.1994, me pasaportë shqiptare, identifikuar me Numer Personal J40206074P, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Z.Enton Lazaj, shtetas shqiptar, lindur në Fier më 18.05.1997, me pasaportë shqiptare, identifikuar me Numer Personal J70518078E, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

KAPITULLI I - EMRI I SHOQËRISË - SELIA-KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1 - Emri i shoqërisë

1.1 Në bazë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themelohet Shoqëria "Red Cat Studio" SH.P.K i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca "SH.P.K" që përfaqëson formën juridike të saj, së cilës këtej e tutje do i referohemi shkurtimisht si "Shoqëria".

1.2 Shoqëria ka statusin e Personit Juridik, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji për Shoqëritë") dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik nga moment i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), në përputhje me Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

1.4 Ortaku i Shoqërisë ("Ortaku" ose "Ortaku i Vetëm") dhe për shmangien e çdo dyshimi Ortaku themelues, gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tij në kapitalin e përfaqësuar në kuota.

1.5 Në çdo dokument, fatura, njoftimet apo publikime të bëra nga Shoqëria, pavarësisht nga mjetet e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga:

- a. Fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SH.P.K"
- b. Numri unik i identifikimit (NUIS)
- c. Selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore
- d. Të dhëna nëse Shoqëria është në proces likuidimi

Neni 2 - Adresa

2.1 Adresa e Shoqërisë do të jetë: **rr. Bajram Allaraj, nr. 13, kodi postar 1010, Tiranë**. Shoqëria me Vendim të Ortakëve mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një qendër operative në një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë ose linjë prodhimi përfaqësimi në çdo vend Brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë sipas gjykimit të Ortakëve.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar duke filluar nga koha e regjistrimit në QKB Për shkaqe dhe arsye të ndryshme, Shoqëria mund të mbarojë aktivitetin e saj në çdo kohë. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.

Neni 4 - Objekti

4.1. Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë është:

Aktivitete të programacionit dhe transmetimit televiziv

Aktivitete fotografike

Aktivitete të projeksionit të filmave

Aktivitete të operatorëve turistikë

Aktivitete të marëdhënieve publike dhe të komunikimit

Aktivitete mbështetëse për shfaqje artistike

Aktivitetet e agjencive të udhëtimit

Krijimtari ose aktivitetet artistike

Aktivitetet e shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive

Publikimi i librave

Post-produksioni i filmave kinematografikë, të videove dhe programeve televizive

Filma, video dhe aktivitetet e prodhimit të programeve televizive

Agjenci publiciteti

Shërbime konsulence në sektorin e informatikës, zhvillimit dixhital, multimedias, programimit, teknologjisë, menaxhimit të sistemeve IT, etj.

Trajnime, leksione, workshope lidhur me industrinë e filmit apo librit

Gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet, që lidhet direkt ose indirekt, që është pasojë e/apo e lidhur me aktivitetet e listuara më lart. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të ndërmarrë çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhënie e marrje me qira e hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë.

4.2 Shoqëria mund të ndërmarrë çdo veprimtari që është në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, i lidhur me të dhe në interes të saj.

4.3 Shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri, sipërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe të gjitha format e bashkëpunimit, brenda qëllimit dhe objektivave të saj.

4.4 Shoqëria duhet të zbatojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo duhet t'i përmbahet standardeve më të mira etike.

4.5 Shoqëria ka të drejtën të bëjë ndryshime të qëllimit të aktivitetit të saj në çdo kohë sipas këtij Statuti.

KAPITULLI II - KAPITALI THEMELTAR

NENI 5 - Kapitali Themeltar

5.1

Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është 10.000 LEKE (dhjetë mijë).

Kuota është e pjestueshme, e transferueshme, e trashëgueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

5.2

Kapitali Themeltar i Shoqërisë prej 10.000 LEKE (dhjetë mijë) zotërohet si mëposhtë:

Renis Hyka, identifikuar me Numer Personal J10911053N . Kontributi i tij në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë do të jetë në shumën **3.300** (tre mijë e treqind) LEKË, e cila e bën **33%** zotërues të totalit prej 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Enton Lazaj, identifikuar me Numer Personal J70518078E . Kontributi i tij në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë do të jetë në shumën **3.300** (tre mijë e treqind) LEKË, e cila e bën **33%** zotërues të totalit prej 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Dionis Prifti, identifikuar me Numer Personal J40206074P . Kontributi i tij në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë do të jetë në shumën **3.400** (tre mijë e katërqind) LEKË, e cila e bën **34%** zotërues të totalit prej 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

5.3 - Depozitimi i Kapitalit themeltar

Depozitimi i Kapitalit Themeltar të Ortakëve në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë do të kryhet me një kontribut të vetëm në para dhe do të paguhet dhe depozitohet përmes një llogarie bankare të hapur në një institucion bankar operues në Republikën e Shqipërisë.

5.4 - Libri i Ortakëve

Shoqëria mund të vendosë me deskricionin e saj për mbajtjen e librit të ortakëve, nën kujdesin e Administratorit, me qëllim për të reflektuar çdo të drejtë të Ortakëve apo të drejtë të palëve të treta mbi kuotat e Shoqërisë (Libri i Ortakëve). Libri i Ortakëve do të përmbajë këto informacione:

- Numrin e kuotave të zotëruara nga Ortaku/ët;
- Datën kur Ortaku apo Ortakët ka fituar pronësinë mbi kuotat
- Emrin dhe adresën apo selinë e Ortakut(Ortakëve)
- Vlerën e kuotave përkatëse të zotëruara; dhe
- Të dhëna mbi çdo peng, barrësim ose çdo të drejtë tjetër reale mbi kuotat.
- Ortaku (Ortakët) kanë të drejtën, që me anë të kërkesës me shkrim, të kërkojnë një ekstrakt to Librit të Ortakut me vulën e Shoqërisë. Ortaku; (Ortakët) ka të drejtën të verifikojë regjistrimin në Librin e Ortakut (Ortakëve) dhe Administratori (Administratorët), nëse kjo kërkohet me shkrim, duhet të sigurojnë asistencën e nevojshme për Ortakun (Ortakët).

5.5

Kuotat do të transferohen në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe do të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe në Librin e Ortakut (Ortakëve).

Kuotat do të transferohen në përputhje me pikat e mëposhtme:

- lajmerim - me afat të caktuar
- miratim nga (60) %
- rendi i prioritetit për transferimin
 - o ortak existues
 - o individ / shoqëri të miratuara sipas pikes 2
- vendim i asamblese

5.6

Ortaku që ka ndermend të shesë kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet me pare të njoftojë ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së pare. Këtë të drejtë ortakut duhet ta ushtrojë Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit. Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së pare, ortakut që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afëruara ortakut tjetër të shoqërisë.

5.7

Në vijim, Ortaku mund të vendosë të zmadhojë ose të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë në çdo kohë në përputhje me nenet e këtij Statuti dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

5.8

Shoqëria ka të drejtë të blejë dhe të anullojë kuotat e saj, si rezultat i zvogëlimit të kapitalit të regjistruar.

5.9

Kapitali i Regjistruar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para ose kontributeve në natyrë, si edhe përmes përfshirjes në to të rezervave ose fitimeve apo edhe përmes konvertimit të borxheve në kuota kapitali.

5.10

Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet përmes sigurimit të kuotave të reja ose rritjes të vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kuotat duhet të regjistrohen dhe vlera e tyre nominale duhet të paguhet plotësisht.

5.11

Kuotat e Shoqërisë janë lehtësisht të transferueshme në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në veçanti me nenin 73 të këtij Ligji.

5.12

Ortakët mund ti ndajnë kuotat e tyre me qëllimin e transferimit të pjesëve të këtyre kuotave në përputhje me ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

NENI 6 - Përbërja e kapitalit

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 7 - Librat e llogarisë

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

NENI 8 - Detyrimet e ortakut

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij .

NENI 9 - Fitimet

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

NENI 10 - Pasuritë e shoqërisë

Shoqëria tregtare "Red Cat Studio" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive së veta tek të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare "Red Cat Studio" sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11 - Pronat e shoqërisë

Shoqëria tregtare "Red Cat Studio" sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortakët kanë pasur para se ajo të krijohet.

KAPITULLI III - DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

NENI 12 - Kompetencat e ortakut

12.1 Ortaku/ët është organi më i lartë i vendimmarrjes në Shoqëri.

12.2 Pronësia mbi kuotat i jep zotëruesit të tyre të drejtat dhe detyrimet, siç parashikohen në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Të

drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga pronësia mbi kuotat janë të transferueshme në çdo zotërues të ri të këtyre Kuotave.

12.3 Ortaku/ët ka të drejtën për të vendosur mbi:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare dhe të investimit të Shoqërisë.
- b. Ndryshimin e Statutit.
- c. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit (Administratorëve) dhe miratimin e skemave të shpërblimeve të tyre
- d. Emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pavarur dhe likujduesve dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre.
- e. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, llogarive dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, nga Administratori.
- f. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, mbi bazën e dokumentave përkatës.
- g. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, mbi bazën e dokumentave përkatëse.
- h. Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
- i. Pjestimi i kuotave dhe anulimim i tyre.
- j. Përfaqësimi i Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër Administratorit (Administratorëve).
- k. Hapjen e degëve dhe filialeve.
- l. Moszbatimin e nenit 17 të Ligjit të Shoqërisë Tregtare mbi ndalimin e konkurrencës. Çdo çështje tjetër sic parashikohet në nenin 82 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- m. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë; dhe
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

12.4 Ortaku/ët mund të thirret për të vendosur për çështjet e mëposhtme, si një kërkesë e detyrueshme e nenit 82 to Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

- a. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton rreziku që aktivët e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b. kur ka një propozim për të shitur apo për të disponuar në mënyrë tjetër aktive asete të cilat kanë një vlerë prej më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

12.5 Në përputhje me nenin 92 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Ortaku/ët mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse anulimin e vendimeve të Administratorit (Administratorëve), kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të Statutit apo të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

12.6 Detyrimet e Shoqërisë, janë të garantuara përmes kapitalit të saj, dhe Ortaku (Ortakët) kanë përgjegjësi deri në vlerën e koutave të mbajtura prej tij/tyre, Ortakët nuk kanë përgjegjësi tej vlerës së investimeve të tyre në kapitalin e Shoqërisë (me përjashtim të huave dhe garancive).

12.7 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhet apo detyrimet të tjera personale të Ortakut (Ortakëve) të saj.

NENI 13 - Procesi i vendimmarrjes së Ortakut/ëve

13.1 Ortaku/ët mund të marrë vendim përmes thirrjes në mbledhje apo në formë të shkruar , në çdo rast kur konsiderohet në të mirë të Shoqërisë.

13.2 Në rast se Ortaku/ët do të marrë vendim në formën e shkruar, Administratori (Administratorët) do t'i dërgojë Ortakut tekstin e vendimit të propozuar së bashku me dokumentacionin që mbështet vendimin me poste, faks apo me mjete elektronike të sigurta të paktën shtatë ditë para datës së propozuar për mbledhjen e asamblesë. Ortaku duhet të miratojë dhe të kthejë vendimin brenda 15 ditëve nga data e dërgimit tek Ortaku/ët të vendimit me shkrim. Ortaku miraton vendimin duke kthyer një kopje të firmosur të vendimit të shkruar tek Administratori (Administratorët) në selinë e Shoqërisë.

13.3 Vendimet e Ortakut të hartuara në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe këtë Statuti do të kenë fuqi detyruese për Shoqërinë. Vendime të tilla mund të merren jashtë Republikës së Shqipërisë dhe evidenca me shkrim e këtij vendimi duhet t'i dorëzohet Administratorit (Administratorëve), i cili (të cilët) duhet të regjistrojë në Regjistrin e Vendimeve të Ortakut (Ortakëve).

13.4 Ortaku thirret për vendimmarrje nga Shoqëria të paktën një herë në vit. Megjithatë kjo thirrje është e detyrueshme në përputhje me rastet e paraqitura në pikën 9.4 të këtij statuti.

13.5 Administratori (Administratorët) duhet të sigurojë që njoftimi i Ortakut duhet bërë në përputhje me formën dhe përmbajtjen në nenin 83 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Mospërmbushja e formaliteteve të njoftimit i bën vendimet e Ortakut të pavlefshme, vetëm nëse Ortaku njeh dhe pranon parregullsitë, deri në masën e lejuar nga ligji.

13.6 Në rastet ku kërkohet nga ligji, disa vendime të Ortakut duhet të noterizohen nga një noter publik shqiptar. Nëse këto vendime janë marrë jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet të hartohen në përputhje me ligjin Shqiptar për njohjen e dokumentave të huaja në Republikën e Shqipërisë (p.sh procedurat e apostilimit apo superlegalizimit, sipas vendit të marrjes së vendimit).

13.7 Të gjitha vendimet e Ortakut të vetëm duhet të regjistrohen në procesverbal dhe në regjistrin e vendimeve të Ortakut. Mbajtur nën kujdesin e Administratorit (Administratorëve) dhe në përputhje me nenin 90 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ("Regjistri i Vendimeve të Ortakut"). Të dhënat e hedhura në këtë regjistër nuk mund të tjetërsohen apo të ndryshohen.

NENI 14 - Drejtuesit

Drejtimi i Shoqërisë është i ndarë ndërmjet :

- a. Ortakut (Ortakët)
- b. Administratori/ët

NENI 15 - Administrimi i shoqërisë

15.1 Shoqëria -administrohet nga 1 (një) administrator

15.2 Ortaku/ët mund të ndryshojë në çdo kohë nëse e konsideron të nevojshme numrin e administratorëve.

15.3 Administratori (Administratorët) mund të jenë të çdo shtetësie dhe emërohen për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh me të drejtë riemërimi.

15.4 Sipas nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 13 të po këtij ligji, i cili citon kushtet e kualifikimit, administratori

i një shoqërië mëmë nuk mund të emërohet, si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

15.5 Në rastet e vdekjes, dorëheqjes, largimit, apo diskualifikimit të çdo Administratori/t, zëvendësuesi i tij duhet të emërohet me vendim të Ortakut/(Ortakëve).

15.6 Ortaku (Ortakët) ka të drejtë të largojë Administratorin (Administratorët) me vendim me shkrim.

15.7 Administratori (Administratorët) pranon që marrëdhënia e tyre në Shoqëri bazohet në mirebesim, në këtë mënyrë vendimi i Ortakut (Ortakëve) për të larguar administratorët konsiderohet një arsye legjitime, në bazë të legjislacionit të zbatueshëm.

15.8 Në rastet kur për lidhjen, ndryshimin dhe zgjidhjen e transaksionit (transaksioneve) kontratës (kontratave) kërkohet një marrëveshje e përbashkët e administratorit (Administratorëve) dhe një marrëveshje e tillë nuk arrihet çështja do t'i referohet Ortakut (Ortakëve) i cili do të zgjidhë çështjen me vendim.

15.9 Ortaku mund të miratojë vendimin i cili i jep të drejtën Administratorit (Administratorëve) që të përfaqësojnë të gjithë bashkë ose individualisht dhe/ose të drejtën për të kryer disa transaksione.

15.10 Administratori duhet të kryejë në çdo kohë ato veprime të kërkuara nga Ortakët në përputhje me këtë Statut dhe ligjin.

15.11 Administratori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë do të jetë:

Dionis Prifti i biri i Andrea dhe Natasha lindur në Fier më datë 06.02.1994, identifikuar me Numer Personal J40206074P. Afati si administrator nis që nga data e krijimit të shoqërisë, 14.02.2025 deri në 14.02.2028.

15.12 Administratori (Administratorët) mund të hap llogari bankare me firmë të vetme.

Dionis Prifti me Numër Personal J40206074P është i autorizuar të kryejë të gjitha transaksionet e nevojshme për të hapur llogarinë përkatëse me qëllimin e depozitimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

15.13 Shoqëria duhet të rimbursojë Administratorin (Administratorët) për shpenzimet e udhëtimeve të arsyeshme të lidhura me prezencën e Administratorit (Administratorëve) në një vend jashtë vendbanimit të Administratorit (Administratorëve) në të mirë të Shoqërisë, vetëm nëse ky rimbursim është bërë pjesë e shpërblimit të të njëjtës.

NENI 16 - Përgjegjësitë dhe të drejtat e Administratorit

16.1 Administratori (Administratores) janë përgjegjës për drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.

16.2 Në veçanti Administratori ka të drejtën dhe detyrimin për të vendosur personalisht dhe të përfaqësojë shoqërinë në:

- a. Drejtimin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të krijuara nga Ortakët.
- b. Të kujdeset për mirëmbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave të kontabilitetit të Shoqërisë.
- c. Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor dhe bilancet e konsoliduara, si dhe raportet të ecures së veprimtarisë dhe i paraqet për miratim te Ortaku bashkë me propozimin për shpërndarjen e fitimeve
- d. Krijimin e një sistemi paralajmerimi në kohën e duhur në lidhje me rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- e. Raportimin tek Ortaku në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të një rëndësie të vecantë për veprimet e Shoqërisë;
- f. Supozimin, sipas formës së një marrëveshjeje ose cdo formë tjetër, e çdo sipërmarrjeje të Shoqërisë kundrejt të tretëve si dhe transferimin apo blerjen e çdo kuote të Shoqërisë nga apo për palët e treta.
- g. Supozimin, sipas formës së një marrëveshjeje ose çdo forme tjetër, lidhjen e çdo kontrate apo ndërmarrjen e çdo veprimi apo transaksioni.
- h. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga Ligji apo Ortaku/ët.
- i. Të kryejë regjistrimet dhe dergojë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit kur është e nevojshme

NENI 17 - Detyrat e Administratorit/ëve

Detyrat e Administratorit/ëve

17.1 Sipas detyrimit të besnikërisë të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtare dhe Shoqëritë Tregtare", paraqitur në Nenet 14,15,17 dhe 18, Shoqëritë Tregtare, Administratori (Administratores) duhet të:

- a. të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga ligji apo ky Statut në mirëbesim dhe në interes të Shoqërisë, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b. të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
- d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë
- e. të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- f. të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

17.2 Administratori (Administratorët) gjatë kryerjes së detyrave përgjigjen kundrejt Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.

17.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

17.4 Në veçanti, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmet nqs në kundërshtim me ligjin kryen veprimet e mëposhtme

- a. I kthen Ortakut/ve kontributet
- b. I paguan interesa apo dividendë të ortakëve
- c. Shpërndarjen e Aseteve të Shoqërisë
- d. Lejon të vazhdojë aktivitetin e Shoqërisë kur duhet parashikuar që ajo nuk do të ketë mundësi të paguajë borxhet e saj.
- e. Të japë hua/borxhe
 - i. Administratori mund të kryej veprime financiare
 - ii. Politikat tregtare do rishikohen me mbledhje të asamblese.

NENI 18 - Shpërndarja e fitimeve

18.1 Ortaku/ët ka të drejtën e përfitimit prej shpërndarjes së fitimit të deklaruar të Shoqërisë bazuar në bilancin e Shoqërisë të miratuar nga Ortaku/ët.

18.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitimet tek ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:

- a. Asetet e Shoqërisë do të mbulojnë plotësisht detyrimet e kësaj të fundit.
- b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

18.3

Administratorët janë përgjegjës ndaj Shoqërisë në lidhje me vërtetësinë e Çertifikatës së aftësisë paguese.

18.4

Sipas nenit 78 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ortaku/ët dhe administratori/rët e shoqërisë kanë përgjegjësi personale për shpërndarjet të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare

KAPITULLI IV - MARDHENIET E PUNES

NENI 19 - Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo mos marrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 21 - Sekreti i punës

Te gjithë të punësuarit ne shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

KAPITULLI V - VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 22 - Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Përfshihet Viti I pare financiar përfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor te te nje viti.

NENI 23 - Inventari dhe llogarite vjetore.

23.1

Shoqëria do te mbaje një kontabilitet te rregullt te pasurisë dhe te veprimtarisë se saj ne pajtim me kërkesat ligjore.

23.2

Ne mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë ne ketë date dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

NENI 24 - Raportet vjetore

24.1

Ne mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

24.2

Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

24.3

Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga

ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 ''Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare''.

KAPITULLI VI - MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 25 - Nderprerja e veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 26 - Menyra e likuidimit

26.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

26.2 Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia venë në dispozicion menjëherë ortakeve.

26.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 27 - Rregullshmeria e likuidimit

Ortaket vendosin mbi rregullshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit. Ortaket mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 28 - Depozitimi i dokumentacionit?

Kur ortaket për shkak të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria c'regjistrohet prej tij.

NENI 29 - Dispozitat ligjore mbi likuidimin

29.1 Për të gjitha ceshtjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

29.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

29.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 30 - Gjykata kompetente

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KAPITULLI VII

NENI 31 Dispozita të ndryshme

31.1 Ky statut mund të ndryshohet ose të zëvendësohet me një tjetër, vetëm me vendim të ortakut/ëve.

31.2 Riorganizimi, ndryshimi i formës ligjore apo prishja e Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare.

31.3 Ortaku/ët dhe administratori/rët do të veprojnë me parimet e ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe në veçanti në përputhje me dispozitat e pjesës së parë, kapitulli 4 të ligjit Për Shoqëritë Tregtare.

31.4 Personat të cilët janë përfshirë në krime të kryera gjatë detyrës së tyre në Shoqëri sipas nenit 163 deri 170 pika a) e Kodit Penal nuk mund të kryejnë funksionet e përfaqësuesit ligjor, administratorit dhe të përfaqësuesit të shoqërisë për një periudhë prej 5 vjetësh nga kryerja e dënimit.

31.5 Shoqëria duhet të përfshijë në raportin e saj vjetor një pasqyrë koherente dhe përshkruese, e cila përmban pikat kryq

rregullave për drejtimin e Shoqërisë dhe praktikave që aplikon në përputhje me ligjin për Shoqëritë tregtare.

31.6 Ortaku me propozimin e Administratorit/ëve, mund të vendosë për krijimin e një fondi rezerve për të përmbushur të papriturat e Shoqërisë ose për barazimin e fitimeve ose për ruajtjen e çdo pasurie të Shoqërisë, ose për çdo qëllim tjetër që ortaku konsideron në interes të Shoqërisë.

31.7 Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë Statut, i nënshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

NENI 32 - Hyrja në fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe zbatimi i tij është i detyrueshëm që nga momenti i firmosjes nga Ortaket.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISE "Red Cat Studio" sh.p.k.

 Digitally signed
by Renis
Hyka

**PRIFTI,
DIONIS** Digitally signed
by PRIFTI,
DIONIS
Date: 2025.01.29
13:19:55 +01'00'

**Enton
Lazaj** Digitally signed
by Enton Lazaj
Date:
2025.01.30
12:04:40 +01'00'

Tiranë, më 14.01.2025 (dy mijë e njëzet e pesë)